



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

aNumri i lëndës: 2020:022755
Datë: 24.06.2024
Numri i dokumentit: 05852455

Ac.nr.1753/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca Dula, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike jokontestimore të propozuesit S.R nga fshati K....., Komuna e K....., të cilin me autorizim e përfaqëson S.K avokat në Lipjan, kundër kundërpropozueses Qeveria e Kosovës (Organi Shpronësues) MMPH, Prishtinë të cilën me autorizim e përfaqëson B.K, Avokat Shtetëror, për caktimin e kompensimit për pasurinë e shpronësuar, duke vendosur sipas ankesës së kundërpropozueses, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, CN.nr.161/17, i datës 11.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.06.2021 mori këtë:

A K T V E N D I M

ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, CN.nr.161/17, i datës 11.01.2021 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar numër, CN.nr.161/17, i datës 11.01.2021, ka vendosur si në vijim:

“I. MIRATOHET në tërësi si i bazuar propozimi i propozuesit S.R nga fsh. K....., Komuna e K.....dhe CAKTOHET kompensimi në shumë prej 28,616.00 Euro, në emër të diferencës për pjesën e shpronësuar për ngastrat kadastrale me nr. dhe, të evidentuara në certifikatën e pronës me numër të lëndës ZK K....., edhe atë –në emër të diferencës financiare për pjesën e shpronësuar të ngastrës kadastrale edhe atë Pk.nr..... në sipërfaqe prej 3071 m2 x7.00 Euro/m2 = në shumën prej 21,497.00 Euro dhe PK.nr..... në sipërfaqe prej 1017 m2 x 7.00 Euro/m2 = në shumën prej 7,119.00 Euro.

II. Urdhërohet kundërpropozuesi-Organi Shpronësues Republika e Kosovës-Qeveria e Kosovës, që propozuesit S.R nga fsh. K....., Komuna e K....., t`ia kompensoj shumën prej 28,616.00, këtë shumë me kamatë prej 7%, duke filluar prej datës 27.10.2017 e deri në pagesën definitive.

III. Detyrohet kundërpropozuesi që propozuesit t`ia paguaj shumën si në pikën II të këtij dispozitivi, si dhe shpenzimet e procedurës jokontestimore në shumë prej 1,888.80 Euro, këto pagesa do të bëhen në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit në dorëzim të këtij aktvendimi, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.”

Kundër këtij aktvendimi kundërpropozuesja, në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes thelbësore së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të refuzojë si të pabazuar propozimin e propozuesit, duke e lënë në fuqi Raportin e Vlerësimit të Organit Shpronësues.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala propozuese.

Propozuesi përmes avokatit S.K, ka paraqitur propozim për caktimin e kompensimit për paluajtshmërinë e eksproprijuar, me kërkesë si në propozim.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të parashtruara nga palët në procedurë, me aktvendimin CN.161/17 të datës 11.01.2021, e ka aprovuar propozimin e propozuesit, duke vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetimin e aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas administrimit të provave ka miratuar propozimin e propozuesit duke e detyruar kundërpropozuesen që propozuesit t`ia paguajë shumën prej 28,616.00 Euro, edhe atë shumën prej 7,119.00 Euro, në emër të diferencës për pjesën e shpronësuar të ngastrës kadastrale, si dhe shumën prej 21,497.00 Euro, për diferencën për pjesën e shpronësuar të ngastrës kadastrale, pronë e paditësit, duke u bazuar në raportin e rivlerësimit të ekspertit vlerësues A.S, të cilit ia fali besimin e plotë, për arsye se eksperti me rastin e përpilimit është bazuar në standardet e aprovuara nga Komiteti Ndërkombëtar i Standardeve të vlerësimit të asetëve, si dhe nga grupi evropian i shoqatave të vlerësuesve “T.....”, ku vlera e tregut përkufizohet si shumë e përafërt e vlerësuar për të cilën pronë do të shkëmbehet në datën e vlerësimit, midis një shitësi të vullnetshëm dhe blerësit të vullnetshëm. Poashtu eksperti është bazuar në informatat-çmimet e aplikuara nga organi shpronësues për ngastrat që gjinden në zonën kadastrale K....., të cilat janë afër dhe kanë karakteristika përafërsisht të njëjta me ngastrat që janë objekt i vlerësimit. Gjykata i ka vlerësuar edhe pretendimet e kunderpropozueses, por që gjeti se janë të pathemelta. Gjykata ka vendosur në pajtim me nenin 15.1 dhe 2, 18.3 dhe nenin 37 të Ligjit Nr.03/L-139 dhe Ligjit Nr. 03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139, për kamatën ka vendosur në bazë të nenit 16 par.2 pika 2.2 të ligjit, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur në bazë të UA 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, nenin 19 të Ligjit për eksproprijim si dhe nenit 222 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pas shqyrtimit dhe ekzaminimit të aktvendimit të atakuar në kuptim të nenit 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), pa u lëshuar fare në vlerësimin e ankesës

të paraqitur dhe pretendimeve ankimore, ka gjetur dhe konstatuar se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës nga 182 paragrafi 2 pika k) të LPK-së, për të cilën shkelje gjykata e ankimit çdoherë duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2, pika k) e LPK-së, qëndron për faktin se në bazë të shkresave të lëndës rezulton se propozimin për caktimin e kompensimit për paluajtshmërinë e eksproprijuar, në gjykatën e shkallës së parë e ka ushtruar dhe nënshkruar avokati S.K nga Lipjani, duke u paraqitur në cilësinë e të autorizuarit të propozuesit, ku i njëjti avokat ka paraqitur parashtrës, ndërsa për seanca e ka bartur autorizimin të avokatit H.K, i cili e ka përfaqësuar propozuesin në seancat gjyqësore, mirëpo në shkresa të lëndës mungon autorizimi i propozuesit dhënë të njëjtit avokat që ta përfaqëson në këtë lëndë jokontestimore, me çka në situatë të tillë del se avokati S.K nga Lipjani, nuk ka pasur autorizim që ta ushtron propozimin në emër të propozuesit, si dhe të bartë autorizimin të avokati tjetër që ta përfaqësojë propozuesin gjatë procedurës jokontestimore të zhvilluar tek gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit, me shikim në shkresat e lëndës, gjeti se mungon autorizimi i dhënë nga propozuesi avokatit S.K, që ta përfaqësojë në çështjen jokontestimore kundër kundërpropozueses, ndërsa avokati në fjalë, përveç që nuk posedon autorizimin e dhënë nga propozuesi, ai bën bartjen e autorizimit të avokati tjetër, që gjendet në shkresat e lëndës shkresat për bartjen e autorizimit e dt. 30.04.2019 dhe e dt. 08.01.2020, nga çka rezulton se as avokati H.K nuk e ka pasur të drejtën ta përfaqësojë propozuesin, kjo për faktin se mungon autorizimi për avokatin S.K.

Me nenin 93 paragraf 1 të LPK-së, përcaktohet se: *“ I autorizuari për përfaqësim ka për detyrë që me rastin e kryerjes se veprimit të parë në procedurë të paraqesë prokurën ”*, ndërsa me nenin 93 paragrafi 4 të të njëjtit ligj, përcaktohet se: *“Gjykata ka për detyrë që gjatë gjithë procedurës të kujdeset nëse personi që prezantohet si përfaqësues është i autorizuar për përfaqësim. Po qe se gjykata konstaton se personi që prezantohet si përfaqësues nuk është i autorizuar nga pala për një gjë të tillë, do ti anulojë veprimet procedurale të kryera nga personi i tillë, po që se veprimet e tij nuk i ka pranuar më vonë”*.

Nga këto arsye, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që në ri procedurë, fillimisht të urdhëroj të autorizuarin e palës propozuese që brenda afatit të caktuar ta paraqes prokurën (autorizimin) e dhënë nga ana e palës propozuese ose aprovimin e saj për veprimet procedurale të kryera dhe pastaj varësisht prej asaj se të njëjtës gjykatë do ti prezantohen apo jo autorizimi i kërkuar apo do të paraqitet aprovimi i palës të cilën e ka përfaqësuar, gjykata të ndërmer hapat tjerë procedural të paraparë me dispozitat ligjore në fuqi, duke pasur parasysh të gjitha veprimet që janë ndërmarrë nga momenti i paraqitjes së padisë e tutje.

Pasi që aktvendimi i shkallës së parë është prishur dhe çështja kthehet në rigjykim, prishet edhe vendimi për shpenzimet e procedurës, sepse në rigjykim do të krijohen edhe shpenzimet tjera lidhur me këtë çështje, andaj gjykata e shkallës së parë duhet ti vlerësojë shpenzimet e gjithmbarshme të këtij kontesti, kur vendosë për çështjen në mënyrë meritore me vendim përfundimtar, e konform nenit 465.3 të LPK-së.

Nga të cekurat me lart, e në mbështetje të nenit 195 paragraf 1 pika c) dhe 198 paragraf 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1753/21, me datë 19.06.2021

Kryetare e kolegjit
Nora Bllaca – Dula, d.v